



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	22.12.2023	12.01.2024	2023/1022
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
vigan syla	27.12.2023		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.12.2023, OE “Megadolon SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me gypa te plastikes , brryla,koka dhe flansha” me nr. të prokurimit: "KEK-23-9146-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 61,500.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 29.08.2023, data e hapjes së ofertës: 20.09.2023, data e vendimit për dhënien e kontratës: 01.12.2023, data e njoftimit të me letër standarde: 01.12.2023.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK gjatë rivlerësimit te tenderit , Vendimin e AK dhe LS dt. 01.12.2023 ka bere shkelje te

neneve te LPP-se Nr-04/L-042 dhe atë te nenit 6,7,59,60,69 Neni 6 – Me te cilin te gjitha Autoritetet kontraktuese janë te obliguara qe te sigurojnë fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrë ekonomike , njëkohësisht duke marre për baze qëllimin .

AK KEK SH.A ka bere shkeljen e këtij neni sepse duke u bazuar ne ofertën e OE ADE Group SHPK e cila është teknikisht dhe administrativisht e pa pergjegjshme e ka rekomanduar për kontratë edhe pse është oferte me çmimin me te larte e pa pergjegjshme duke mos zbatuar parimin e ekonomicitetit sipas këtij neni te LPP-se se Kosovës.

Është Shkelur neni 7 pika 1. E këtij neni te LPP-se Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminim 1.Autoriteti Kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo diskriminuese te cilën komisioni gjate vlerësimit nuk e ka zbatuar ketë nen duke na dëmtuar neve si OE dhe AK duke propozuar për kontratë OE ADE GROUP shpk si ofertë me çmimin me te larte te pa pergjegjshem teknikisht dhe administrativisht .

Është shkelur neni 59 I LPP-se AK KEK – sha. Gjate vlerësimit ka shkelur ketë nen duke mos bere vlerësimin e tenderit ne mënyrë profesionale nga aspekti teknik as administrativ , bazuar ne dokumentacionin e prezantuar te OE ADE GROUP shpk te rekomanduar për kontrate I cili rekomandim është plotësisht I pa drejte sepse është I pa përgjegjshëm teknikisht dhe Administrativisht.

Është shkelur neni 60 I LPP-se Kriteret për dhënien e Kontratës 1.Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik qe ka dorëzuar ose 1.1 tenderin e pergjegjshem me çmimin me te ult 1.2 tenderin ekonomikisht me te favorshëm ne baze te kriterave dhe peshën qe është specifikuar ne dosjen e tenderit sipas nenint paragrafit 3. Te nenit 52 te këtij ligji. AK nuk I ka respektuar asnjë pike te këtij neni sepse ka prezantuar OE ADE GROUP SHPK për kontrate I cili nuk e plotëson asnjërën nga këto kriteret te këtij neni.

Është Shkelur neni 69 – Te Aftesia Teknike dhe Profesionale Është shkelur ky nen sepse AK gjate procesit te vlerësimit nuk është bazuar ne dokumentacionin e paraqitur te OE te propozuar për kontrate , ku sipas dokumentacionit te paraqitura ne oferte shifet se ai nuk I ka plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale siç janë kërkuar ne FDT pika 9.1&9.2 si dhe kriteret e obligueshme teknike ne ANKES 1 te DT.

KRITERET PËR VLERËSIM

		<p>Kërkesat e përshtatshmërisë:</p> <p><u>1.Operatori ekonomik</u> duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65. <u>2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik</u>, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohe vetëm për fituesin e tenderit. <u>3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë” Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohe vetëm për fituesin e tenderit.</u></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p><u>1.Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit.</u> Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika 2, dhe 3 do të kërkohe nga tenderuesi të cilin autoriteti kontraktues ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet</p>
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<p>Përshtatshmëria profesionale</p> <p><u>1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;</u> <u>2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit</u> <u>3.Regjistrimi i numrit fiskal</u></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p><u>1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit);</u> <u>2.Kopja e certifikatës TVSH-se;</u> <u>3.Kopja e certifikatës numrit fiskal</u></p>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p> <p><u>1.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet</u> <u>2. Katalogë apo prezantime grafike (vizatimet) dhe ose fotografi të produkteve për furnizim,bashkangjitur përshkrimit teknike detale për artikujt qe ofertoni</u></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p><u>1.Certifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015)</u> <u>2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese të katalogut nga prodhuesi dhe apo vizatime të vërtetuara nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni.</u></p>

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES SH.A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.O.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me gypa të plastikës, brryla, koka dhe flansha

Numri i aktivitetit të prokurimit: KEK-23-339-121 (KEK-23-9146-1-2-1)

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	"A- D- E Group" SH.P.K., DRENOC PN, 10000, PRISHTINE	47,436.00
2.	Megadolon SH.P.K., Rruga Shaqir Ingrishta, 1000, KOSOVO	44,779.82
3.	DIAMANTI SH.P.K., Rr.Naim Frasheri nr.16, 10000, Prishtinë	51,281.68
4.	"I.E.C - BIO " L.L.C, Qendra Tregtare B.diellit Lok.63, 10000, prishtine	58,563.40
5.	"CMC GROUP " SH.P.K., SU1/5-H-IV-Nr.12, Dardani, 10000, Prishtine	48,089.95
6.	EKSIM COM SH.P.K., Bill Klinton Nr 269, -, PRISHTINË	58,437.90
7.	"Infra-Plus " SH.P.K., Rr.Luan Haradinaj Sol.1 H.1, 10000, Prishtinë	56,651.80

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. shpërblen me kontratë: OE "A- D- SH.P.K, në vlerë totale të ofertës 47,436.00 (me TVSH).

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit:

Data:

01.12.2023

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Megadolon SH.P.K.**

OE ankues i pakënaqur me vendimin B58 të AK-se të datës: 01.12.2023, ka dorëzuar ankese në OSHP, me pretendimin se AK-ja, ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 6,7,59,60,69 të LPP-se.

Shqyrtimi i pretendimeve ankimore të cilat kanë të bëjnë me çështjet teknike.

Pretendimi nr 1.

Jane bërë keto shkelje:

a.Neni 9.1&9.2 i DT pika 2.1 është kërkuar : Dokumentacioni Autentik i prodhuesit si kataloge pjesë të katalogut nga prodhuesi dhe apo vizatime të vertetuara nga prodhuesi me përshkrime teknike detale për artikujt që oferton.

Gjithashtu është kërkuar që gypat dhe brrylat nga poz 1-10 duhet të jenë sipas vizatimeve të AK

OE ka ofruar kataloge të nenvizuara të cilat nuk janë në përputhje me specifikimin teknik të FDT , Oe i propozuar për kontratë ka prezantuar për poz 1-6 kataloge dhe vizatime JO autentike por ka nderhyrje në Vizatimet e AK duke i vendosur logon e prodhuesit si të vetin (prodhues) e cila nderhyrje konsiderohet e falsifikuar ,SHIQO Dokumentin 1.

Pergjigjeje ne pretendimin nr 1.

OE ankues Megadolon SHPK pretendon se nga ana e OE të rekomanduar OE ADE GROUP SHPK, nuk janë plotësuar kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale në pikat 9.1 dhe 9.2 të DT. Këto kërkesa përfshijnë certifikatat e produkteve, katalogët apo prezantimet grafike (vizatimet), dhe fotografitë e produkteve, të shoqëruara me përshkrim teknik detajuar për artikujt që ofertohen. Këto duhet të dëshmohen me certifikata, dokumentacion autentik të prodhuesit, si dhe kataloge dhe/ose vizatime të vërtetuara nga prodhuesi me përshkrim teknik detajuar. OE ankues pretendon se për pozicionet 1-10, kërkesat e DT nuk janë plotësuar dhe pajisjet e ofertuara nuk i përmbushin këto kërkesa. Megjithatë, pas administrimit të dokumentacionit dhe katalogut për pozicionet 1-10, konstatohet se për pozicionin e gypave, OE i rekomanduar ka prezantuar gypa nga kompania Gemaplast-tim, të cilat plotësojnë kërkesat teknike të definuara në ANEKS1, duke përfshirë vizatimet me dimensione, të tipit SRD11 dhe me drashesinë e mureve në përputhje me kërkesat e ANEKS1. Ndërsa, brrylat e tipit 45 dhe 90 shkallë janë nga kompania Elbor dhe po ashtu plotësojnë kërkesat sipas ANEKS1 dhe vizatimeve, duke përfshirë trashesinë e mureve dhe dimensionet sipas kërkesave në DT. Lidhur me këtë pretendim, bazuar në sqarimin e dhënë më lart, eksperti teknik mendon se pretendimi **ankimor është i PABAZUAR.**

Pretendimi nr 2.

Aneksi 1. FTD Specifikimin teknik , deklaratën mbi origjinën dhe përshkrimin e qmimeve të OE I propozuar për kontratë e ka plotësuar si prodhues për të gjitha pozicionet gypa , flansha dhe kokat se prodhues është Gemaplast duke mos prezantuar katalog apo vizatim të GEMAPLAST për flansha të metalit dhe koka edhe pse nuk I prodhon ato por OE ADE GROUP SHPK e ka prezantuar si prodhues të tyre dhe vendi I origjinës e ka prezantuar për flansha metalike dhe koka që është Maqedonia e Veriut sepse ai prodhon vetëm gypat e plastikës ku nuk dëshmohet se I prodhon edhe flanshat e metalit dhe kokat e plastikës , Argument nga qertifikata ISO 9001:2015 ku shihet se ky prodhues është vetëm I gypave të plastikës dhe, Prodhues I Fllanshaave të metalit dhe kokave të plastikës është ELBOR TURQI.

Karakteristika teknike të artikujve të cilat I ka ofuruar OE I propozuar për kontratë nuk janë sipas specifikimeve teknike të dosjes së tenderit .Shiqo dokumentin nr .2

Pergjigjeje ne pretendimin nr 2.

Në lidhje me autentifikimin e dokumentacionit të prezantuar nga ana e OE të rekomanduar, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar në ofertën e OE të rekomanduar, mund të thuhet se OE i rekomanduar ka paraqitur një dokument (katalozi i certifikati.pdf) që paraqitet si një katalog i përbërë nga dokumentacioni i dy prodhuesve të ndryshëm, por pa vertetim nga ana e prodhuesit. Dokumentat e tjera, të cilat janë prezantuar si dokumentacion për vizatime teknike (drawings.pdf) të produkteve, janë ndërtuar duke i vënë logon e njërit nga prodhuesit (Gemaplast-tim), gje që nuk

përputhet me kërkesën e DT, ku është kërkuar që OE të prezantojë dokumentacion të vertetuar nga prodhuesi me përshkrim teknik për produktet e ofertuara. Mbi të gjitha, lidhur me specifikimin e origjinës së pajisjeve, sic është kërkuar në ANKES1, konform dokumentacionit të prezantuar, shihet mos-përputhje mes dokumenteve të prezantuara në ofertë, katalog dhe specifikacion teknik (S.TEKNIK.pdf), ku në katalog duket se kemi të bëjmë me prodhues të ndryshëm, ndërsa tek specifikacioni teknik nga ana e OE të rekomanduar është prezantuar vetëm një, duke përcaktuar vetëm Gemaplast-tim si vendin e origjinës së produkteve. Prandaj, bazuar në këtë çështje, eksperti teknik mendon se pretendimi **ankimor është i BAZUAR**.

Pretendimi nr.3

Poz.11 Koka per gyp ate plastikes o 225 , Oe ka ofruar 21.6m eshte kerkuar trashesia 20.5mm OE e ka ofruar me gjatesi 196mm eshte kerkuar koka me gjatesi 200mm ka ofruar dimezion 196mm , dimensioni I kerkuar eshte 200mm Poz.12 – Koka per gyp ate plastikes o 250 , ka ofruar koken me trashesi 23.5mm eshte kerkuar koka me trashesi 22.7mm Poz.13- Fllansha te celikta per gyp ate plastikes o 225mm ka ofruar o238 mm eshte kerkuar fllansha o245 mm eshte kerkuar fllansha me trashesi 20mm, ka ofruar 24mm Poz.14 Fllansha te celikta per gyp ate plastikes o 250mm ka ofruar o350mm eshte kerkuar 4/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK fllansha o352mm Eshte kerkuar fllansha me trashesi 25mm ka ofruar 26mm Te gjitha keto dimensione ofertuesi I rekomanduar per kontrat I ka ofruar duke I prezantuar te nenvizuara ne katalogun e prezantuar te prodhuesit me dimensione te gabuara .

Pergjigje ne pretendimin nr.3

Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar ka paraqitur produkte me anë të katalogeve që nuk plotësojnë kërkesat e DT dhe nuk përputhen me kërkesat e vizatimeve teknike (9.1 dhe 9.2) të kërkuara në ANKES1 dhe vizatimeve teknike në DT, pas shqyrtimit të specifikacioneve teknike të pajisjeve të prezantuara në ofert shihet se kemi mos përputhje në mes kërkesave të DT dhe pajisjeve të ofertuara një gjë e tillë është skjaruar edhe në raportin e komisionit të vlerësimit të bërë nga ana e AK, OE i rekomanduar nuk ka prezantuar produkte që plotësojnë kërkesat për pozicionet 11, 12, 13 dhe 14, të kërkuara me anë të vizatimeve teknike. Prandaj, bazuar në shqyrtimin e mësipërm, pretendimi ankimor i OE ankues kundrejt vendimit të AK **vlerësohet si i BAZUAR**.

Eksperti shqyrtues, sqaron se pergjigjjat ne pretendime ankimore jane dhene nga Eksperti teknik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES


Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“Megadolon SH.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me gypa të plastikës , brryla,koka dhe flansha”** me numër të prokurimit: **“KEK-23-9146-1-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues- Teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Megadolon SH.P.K.**

Florije Rexhepi



vigan syla

